



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec

Skupština Opštine Oraovac / Municipal Assambly Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KOMITETI PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA P R O C E S V E R B A L

Mbledhja dytë e Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara, e mbajtur më datë 18.04.2025 (e premte), me fillim në ora 10:10.

Mbledhjen e kryesoi zëvendëskryesuesi i komitetit, **z. Atdhe Rama**. Të gjithë anëtarët e komitetit ishin të pranishëm në mbledhje.

Për këtë mbledhje është propozuar ky:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Zgjedhja e kryesuesit të ri të Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara;
4. Të ndryshme.

Zëvendëskryesuesi: Mirëmëngjesi! Përshëndetje për të gjithë! Jemi mbledhur sot në takimin e dytë të Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2025. Vazhdojmë me leximin e rendit të ditës. Atëherë, rendin e ditës si të tillë e vendosim në votim! Kush është “pro”?... Unanimisht aprovohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Zëvendëskryesuesi: Atëherë, nëse dikush ka ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është pro? Unanimisht aprovohet edhe procesverbali i mbledhjes së kaluar.

2. Zgjedhja e kryesuesit të ri të Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara:

Zëvendëskryesuesi: Pikën e dytë ka të bëjë me zgjedhjen e kryesuesit ose kryeses. Pasi që Almedina nuk është më dhe ka dhënë dorëheqje, ne si komitet duhet t'i bëjmë propozimet tona.

Skender Hamza: Faleminderit Atdhe! Procedurat janë me votë të hapur dhe të fshehur. Së pari duhet t'i bëni propozimet.

Nashide Shehu: Atëherë, unë propozoj Atdhe Ramën.

Zëvendëskryesuesi: Faleminderit Nashide, por preferoj të qëndroj zëvendëskryesues. Unë propozoj Samra Kërqagun, sepse kjo gjatë gjithë kohës merret dhe punon me fëmijë me aftësi të kufizuara.

Selman Shtavica: Atdhe, ne kemi të drejtë t'i shprehim mendimet tona. Unë propozoj Nashide Shehun!

Nashide Shehu: Faleminderit! Unë tërhiqem, sepse është mbledhja e parë si anëtare e komitetit dhe nuk më takon të zgjedhem kryesuese.

Zëvendëskryesuesi: Faleminderit, nëse nuk ka propozime të tjera, e vendosim në votim propozimin për Samra Kërqagun. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 4 vota “për”, asnjë kundër dhe 1 abstenim, Samra Kërqagu është kryesuesja më e re e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara. E ftojme të ulet në vend të vetin.

Kryesuesja: Përshëndetje për të gjithë! Ju falënderoj shumë për votim dhe ju siguroj që këtë punë do ta kryej me përkushtim të madh. Atëherë na ka mbetur edhe pika e tretë apo e fundit.

4. Të ndryshme:

Zëvendëskryesuesi: Atëherë, e lus sekretarinë e kuvendit që në mbledhjen e ardhshme të na tregojë se sa janë përmbushur rekomandimet tona dhe sa të tjera kanë filluar të zbatohen.


Skender Hamza: Sekretaria e kuvendit nuk e ka për detyrë që t'ju përgatisë këtë raport. Ne si sekretari mund t'ju ndihmojmë vetëm përmes procesverbaleve. Është kolegu Albion që i mban dhe mund t'ju dërgojmë, ndërsa ju si komitet t'i shikoni nëse rekomandimet e dala nga mbledhjet e mbajtura janë zbatuar ose jo.

Selman Shtavica: Unë edhe më herët i kam pasur dy kërkesa për Drejtorinë e Arsimit. Njëra ndër kërkesat ka qenë formimi i komisionit i cili verifikon që fëmijët janë me aftësi të kufizuara. E kemi një rast në fshatin Retijë, ku një fëmijë 9 vjeçar nuk i vijon mësimet shkaku i bullizimit.

Zëvendëskryesuesi: Selman, nuk e di nëse komisioni i tillë mund të ndikojë në trajtimin më të mirë të fëmijëve me aftësi të kufizuara, kur në fakt ekziston Hendikosi. Komisioni e ka për detyrë vetëm t'i verifikojë dhe të vazhdojë të merret me fëmijët në fjalë. Në këtë rast, ne si komitet rekomandojmë që psikologët dhe pedagogët e shkollave të merren veçanërisht me personat me aftësi të kufizuara në shkolla.

Ferat Durguti: Nuk kemi informata të sakta nëse ka psikologë ose jo, nëpër shkollat e komunës sonë. P.sh: në rastin specifik në Retijë.

Kryesuesja: Atëherë, nëse nuk ka dikush diçka tjetër, ju falënderoj të gjithëve për kontributin. Shihemi në mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi

Albion Krasniqi

Kryesuesja e komitetit

Samra Kërqagu